

DEKRET
Nr. 276, datë 4.10.2023

PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË AKADEMISË SË SIGURISË

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “g” dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 39, pika 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, pikës 7, të vendimit nr. 881, datë 28.10.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të saj”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 12, datë 30.7.2023, të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve të Akademisë së Sigurisë, “Për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve të para për autoritetin drejtues, në pozicionin Rektor të Akademisë së Sigurisë”, me propozim të ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Ilirjan Mandro, emërohet rektor i Akademisë së Sigurisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj